




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.Nr.317/2022

Datë: 7 korrik 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7, paragrafi 1, pika 1.2, 1.14, dhe nenit 8, të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur në çështjen ndaj Rafet Ismajli, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj, në mbledhjen e mbajtur të mbajtur me 7 korrik 2022, nxjerr:

V E N D I M

I propozohet Presidentes së Republikës së Kosovës, shkarkimi nga pozita e gjyqtarit Rafet Ismajli, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 27.09.2019, ka pranuar nga ish Kryetari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Nikolla Kabashiq, kërkesën për fillimin e hetimeve dhe pezullimin e gjyqtarit Rafet Ismajli, për shkelje disiplinore të nenit 5, paragrafi 2.5, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Kërkesën për pezullim ish Kryetari Kabashiq e ka mbështetur në njoftimin e Blerim Isufaj, Prokuror në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, i cili e ka njoftuar se gjyqtari Rafet Ismajli është arrestuar me 26.09.2019, nën dyshimin se ka kryer veprën penale keqpërdorim i detyrës zyrtare nga neni 414 par.1 të KPRK-së.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me vendimin KGJK.nr.189/2019, të datës 27 shtator 2019, e ka pezulluar nga detyra e gjyqtarit Rafet Ismajlin, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj, e ka suspenduar procedurën disiplinore dhe e ka ndërprerë parashkrimin deri në përfundim të procedurës penale. Gjatë kësaj periudhe bazuar në nenin 12, paragrafi 10, të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve gjyqtari Rafet Ismajli ka pranuar vetëm 50% të pagës mujore.

Këshilli është njoftuar nga Gjykata Themelore në Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, se gjyqtari Rafet Ismajli me aktgjykimin me numër PS.nr.18/21, të datës 11.02.2022, është shpallur fajtor për veprën penale ushtrim i ndikimit nga neni 424, paragrafi 1, të KPRK-së.

Gjyqtarit Rafet Ismajlit me aktgjykimin me numër PS.nr.18/21, të datës 11.02.2022, i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej njëzet (20) muajve, të cilin do ta vuan në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditës pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi si dhe dënimin me gjobë në lartësi prej një mijë (1000) euro, të cilin do ta paguajë në afat prej tri (3) muajve, pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

Në harmoni me nenin 62, të KPRK-së, gjyqtarit Ismajli i është shqiptuar edhe dënim plotësues si:

Ndalim i ushtrimit të funksioneve në administratë publike ose shërbim publik, në kohëzgjatje prej 2 viteve pas ekzekutimit (vuajtjes) së dënimit.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 05.07.2022 ka pranuar nga Gjykata e Apelit aktgjykim APS.nr.14/2022 të datës 26.05.2022, me të cilin është refuzuar ankesa e të akuzuarit Rafet Ismajli dhe mbrojtësit të tij av. Naim Rudari, ndërsa është vërtetuar aktgjykimin PS.nr.18/2021, i datës 11 shkurt 2021, i Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore Prishtinë.

Në këtë drejtim, Këshilli pas pranimit të aktgjykimit APS.nr.14/2022, i datës 26.05.2022, të Gjykatës së Apelit, me të cilin është vërtetuar aktgjykimin i Gjykatës Themelore Prishtinë, ka mbajtur mbledhjen në të cilën ka shqyrtuar vendimin KGJK.nr.189/2019, të datës 27 shtator 2019, me të cilin gjyqtari Rafet Ismajli ka qenë i pezulluar nga ushtrimi i detyrës së gjyqtarit.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të kësaj çështje, duke u bazuar në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, me anë të cilit gjyqtari Rafet Ismajli është shpallur fajtor për veprën penale “Ushtrimi i ndikimit” nga neni 424 paragrafi 1 i KPRK-së, KGJK konform nenit 8 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, pas dënimit të gjyqtarit për veprë penale përkatësisht edhe shkelje të qëllimshme të ligjit, në mënyrë unanime vendosi që t’i të propozojë Presidentes së Republikës së Kosovës shkarkimin e z. Rafet Ismajli nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit në Gjykatën Themelore Mitrovicë-Dega në Skenderaj.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.nr.317/2022, datë: 7 korrik 2022

Alber ZOGAJ



Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 15 ditëve nga pranimi i vendimit.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Ljiljana Stevanovic, Kryetare, Gjykata Themelore në Mitrovicë;
- Rafet Ismajli,;